

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com

GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS

përmes

GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

lidhur me lëndën **A. nr. 3090/19**

Paditës-propozuesi:

Sami Kurteshi, rr. Xhavit Ahmeti, nr. 9/A, 10000 Prishtinë
përfaqësuar me autorizim nga juristi Getoar Mjeku

ndaj të paditur-kundërpropozueses:

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) e Republikës së Kosovës
rr. Dervish Rozhaja, nr. 12, 10000 Prishtinë

dhe palës së interesuar:

Building Construction L.L.C., pa adresë

paraqet:

PËRGGJIGJE NË ANKESË

sipas ligjit:

Ligji për procedurën kontestimore, 03/L-006, ndryshuar, neni 187.1

ndaj parashtrës:

Ankesa e 31 janarit 2020 e palës së interesuar kundër Aktvendimit të 27 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore të Prishtinës

me propozim Gjykatës:

ta hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme ose të palejueshme ose
ta refuzojë ankesën si të pathemeltë

Prishtinë, 13 shkurt 2020

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
A. Përmbledhje.....	3
B. Çështjet në shqyrtim.....	3
C. Procedura dhe faktet.....	4
D. Arsyetimi juridik.....	4
II. Argumentet.....	5
A. Ankesa e pasafatshme.....	5
B. Ankesa e palejueshme: Pala nuk ka personalitet juridik.....	5
C. Ankesa e pathemeltë: Aktvendimi mbështetet në ligj e fakte.....	6
III. Propozim.....	9

I. HYRJJE

A. Përmbledhje

1. Ankesa është paraqitur mbi 15 ditë pas dorëzimit të aktvendimit, dhe ankuesi s'është person fizik as juridik. Andaj Gjykata duhet ta hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme ose të palejueshme. Nëse e shqyrton, duhet ta refuzojë atë, sepse aktvendimi mbështetet në ligj e fakte.

B. Çështjet në shqyrtim

2. Në shqyrtim para gjykatës janë këto çështje juridike:
 - (1) Ligji jep 15 ditë afat për ankesë pas ditës që dorëzohet aktvendimi.¹ Aktvendimi është dorëzuar më 14 janar 2020, kurse ankesa më 31 janar. A është e afatshme ankesa?
 - (2) Ligji s'lejon me paraqitë ankesë pa qenë person fizik ose juridik dhe pa pasur interes juridik.² «Building Construction L.L.C.» s'është biznes i regjistruar, nuk ka adresë, emër përfaqësuesi a numër identifikues, s'ka qenë palë e procedurës administrative, dhe nuk dëmtohet nga aktvendimi. A është e lejueshme ankesa?
 - (3) Ligji lejon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ nëse paditësit i kanoset dëm vështirë i riparueshëm, shtyrja nuk cenon interesin publik, dhe shtyrja s'u shkakton «dëm të madh» palëve të interesuara.³ Themeloria ka shtyrë një vendim për të subvencionuar prodhues të paracaktuar të energjisë. Vendimi rrezikonte shtrenjtimin e rrymës për miliona euro për konsumatorët si paditësi. Shtyrja nuk cenon interesin publik, sepse mbron konsumatorin e tregun. As u sjell dëm të madh të interesuarve, meqë s'kanë pasur pse të investojnë para vendimit, kurse subvencionet jepen për kohë fikse, kurdo që të fillojnë. A ka vepruar sipas ligjit dhe fakteve Gjykata Themelore?

1 Ligj 03/L-006, për procedurën kontestimore (LPK), nenet 176.1 dhe 208.

2 LPK, nenet 186.1, para. 1 dhe 3, dhe 196.

3 Ligj 03/L-202, për konfliktet administrative (LKA), neni 22.

C. Procedura dhe faktet

3. Më 27 nëntor 2019, e paditura-kundërpropozuesja Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) ka nxjerrë vendim për të caktuar tarifa që u paguhen prodhuesve të energjisë nga burime të caktuara të ripërtëritshme.⁴
4. Më 24 dhjetor 2019, paditësi dhe propozuesi Sami Kurteshi ka parashtruar në Gjykatën Themelore të Prishtinës padi ndaj vendimit të ZRrE-së dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit.
5. Më 27 dhjetor 2019, brenda afatit të ligjshëm, gjyqtarja Arjeta Sadiku, e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore, ka nxjerrë aktvendim që miraton kërkesën e paditës-propozuesit Kurteshi.
6. Aktvendimi i 27 dhjetorit 2019 u është dorëzuar palëve kah mesi i janarit 2020. Përfaqësuesi i paditës-propozuesit ka marrë kopjen e aktvendimit më 14 janar 2020. E paditur-kundërpropozuesja është ankuar, dhe paditës-propozuesi ka kthyer përgjigje në ankesë.
7. Më 31 janar 2020, ankesë ka paraqitur pala «Building Construction L.L.C.», por pa adresë, numër biznesi a emër përfaqësuesi. Ankesa i është dorëzuar përfaqësuesit të paditës-propozuesit më 7 shkurt 2020.

D. Arsyetimi juridik

8. Kur Ligji për konfliktet administrative nuk ka rregulla për procedurën, zbatohet përshtatshmërisht Ligji për procedurën kontestimore.⁵ LPK përcakton se në procedurën ankimore ndaj aktvendimit vlejné rregullat e aktgjykimit.⁶ Ankesa dorëzohet në gjykatën e shkallës së parë. Kur pala e pakënaqur parashtron ankesë, gjykata ia dërgon një kopje palës tjetër e cila «mundet, brenda fatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankesë».⁷
9. Paditës-propozuesi po paraqet këtë përgjigje në ankesë në gjykatën e duhur dhe brenda afatit ligjor — brenda 7 ditësh pasi ka pranuar ankesën. Prandaj, Gjykata e nderuar duhet ta shqyrtojë përgjigjen.

4 Vendim V_1204_2019 i 27 nëntorit 2019 i Bordit të ZRrE-së, në dosjen e lëndës.

5 LKA, neni 63.

6 LPK, neni 208.

7 LPK, neni 187.1.

II. ARGUMENTET

A. Ankesa e pasafatshme

10. Gjykata kujdeset për afatet sipas detyrës zyrtare. Themelorja ose Apeli hedh poshtë si të pasafatshme ankesën e dorëzuar jashtë afatit.⁸ Ligji jep 15 ditë afat për ankesë pas ditës që nxirret ose dorëzohet aktvendimi.⁹ Aktvendimi i goditur është nxjerrë më 27 dhjetor 2019, palët e kanë pranuar atë më 14 janar 2020, kurse ankuesi «Building Construction L.L.C.» ka dorëzuar ankesën e vet më 31 janar 2020. Për më tepër, askund në ankesë nuk ceket data kur ankuesi ka marrë vesh për aktvendimin. Kështu është e qartë se ankesa është dorëzuar pas afatit dhe duhet hedhur poshtë.

B. Ankesa e palejueshme: Pala nuk ka personalitet juridik

11. Gjykata kujdeset për legjitimitetin e palëve ndërgjyqëse sipas detyrës zyrtare. Themelorja ose Apeli hedh poshtë si të palejueshme ankesën nga palët e paautorizuara ose pa interes juridik.¹⁰ Pala që nuk është as person fizik as person juridik nuk mund të ushtrojë ankesë.
12. Ndonëse pretendon të jetë person juridik, pala «Building Construction L.L.C.» nuk është e tillë. Mbaresa «L.L.C.» domethënë *limited liability company*, që shqip i bie shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Mirëpo Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve nuk ka asnjë entitet, vendor a të huaj, të regjistruar me emrin «Building Construction L.L.C.». Në 12 faqe ankesë, nuk ka as emër biznesi të regjistruar, as emër e mbiemër të përfaqësuesit, as adresë fizike të palës, as numër identifikues. Ankuesi nuk ka personalitet juridik, andaj nuk mund të ushtrojë mjete juridike siç është padia.
13. Nëse ankuesi është i regjistruar në një shtet tjetër nuk ka aspak rëndësi; për të vepruar në Kosovë dhe për të përfituar nga një skemë e

8 LPK, nenet 186, para. 1–2, dhe 196.

9 LPK, nenet 176.1 dhe 208.

10 LPK, nenet 186, para. 1 dhe 3, dhe 196.

ZRrE-së, lypset me pasë biznes të regjistruar në Kosovë. Përndryshe, s'mund të ketë as interes juridik në ecurinë gjyqësore me ZRrE-në.

14. Në pamundësi për ta dëshmuar legjitimitetin e vet, ankuesi ka provuar të sulmojë të drejtën e zotit Kurteshi për ta paditur ZRrE-në. Por këtë të drejtë z. Kurteshi e gëzon në sajë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në rastin *Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut*, që ua njeh qytetarëve interesin juridik për të sfiduar tarifatat që i cakton shteti.¹¹ Legjitimiteti i paditësit është argumentuar mirë në parashtrësën fillestare.¹²
15. Rrjedhimisht, ankesa e palës «Building Construction» duhet hedhur poshtë si e palejueshme.

C. Ankesa e pathemeltë: Aktvendimi mbështetet në ligj e fakte

16. Ndonëse ankesa lejohet për shkelje të rregullave të procedurës ose keqkonstatim të fakteve,¹³ asnjë nga këto rrethana nuk ka ndodhur me aktvendimin e shkallës së parë. Për të dëshmuar se Gjykata Themelore ka vepruar drejt, paditës-propozuesi përfshin në këtë përgjigje argumentet nga përgjigjja në ankesën e ZRrE-së, dorëzuar më 30 janar 2020.

Gjykata Themelore ka zbatuar drejt ligjin, duke miratuar kërkesën mbi provat e paraqitura

17. Aktvendimi i Themelores mbështetet në nenin 22 LKA. Sipas paragrafit 6, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ. Sipas paragrafit 2, gjykata miraton kërkesën nëse:
 - (1) ekzekutimi i shkakton paditësit dëm që vështirë riparohet;
 - (2) shtyrja nuk cenon interesin publik; dhe
 - (3) shtyrja nuk i sjell «dëm të madh» palës së interesuar.
18. Gjykata Themelore ka shtyrë ekzekutimit në bazë të parashtrësës së zotit Kurteshi, që ngërthen padinë dhe kërkesën për shtyrje. Parashtrësja — e mbështetur me argumente dhe prova, që përfshijnë llogaritjen e dëmit — përmbush secilin element të kërkesës për shtyrje: se

11 Rasti KI 11/09, GjKK, Vendim, f. 3, para. fundit.

12 Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, pjesa IV.C, para. 42–45.

13 LPK, neni 181.1.

paditësit i kanoset dëmi vështirë i riparueshëm, se shtyrja nuk cenon interesin publik, dhe se shtyrja nuk dëmton palët e interesuara.¹⁴

19. Gjykata nuk ka pasur detyrim ta njoftojë ankuesin «Building Construction», siç pretendon ai në parashtresë.¹⁵ Meqë aktvendimi për shtyrje të ekzekutimit merret brenda tri ditësh, Gjykata nuk dëgjon as personat që janë palë në procedurë.¹⁶ Njëherësh, ka gjykuar drejt legjitimitetin aktiv të paditës-propozuesit, që po ushtron të drejtën e njohur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.¹⁷
20. Rrjedhimisht, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendim të ligjshëm, dhe Gjykata e Apelit duhet ta vërtetojë atë.

Gjykata Themelore ka vlerësuar mirë faktet, duke konstatuar rrezikun e dëmit për paditësin dhe duke vënë re interesin publik

21. Gjykata ka konstatuar saktë dhe në plotëni gjendjen faktike, ashtu siç përshkruhet në parashtresën e paditës-propozuesit Kurteshi dhe siç mbështetet me fakte notore dhe prova të dorëzuara në gjykatë.
22. Së pari, parashtresa dëshmon se vendimi i ZRrE-së shtrenjton rrymën elektrike, duke ua ngarkuar të paktën 16,46 milionë euro paditësit dhe konsumatorëve të tjerë. Ky dëm pasuror (dhe çfarëdo dëmi tjetër përcjellës) vështirë se do të riparohej pas zgjidhjes së kontestit.¹⁸
23. Së dyti, mbrojtja e konsumatorit dhe e tregut të lirë është jo vetëm në përputhje me interesin publik — është detyrim kushtetues e ligjor i organeve, përfshi të paditurën ZRrE.¹⁹ Ankuesi tani përmend shumë që Kosova paguan për të importuar energji. Por zëvendësimi i importit as nuk lejohet me normat në fuqi e as nuk është synim i ZRrE-së, përkundër shkeljeve të shumta. Energjia e importuar prapë kushton më lirë: rreth 50 euro për MW, për dallim nga tarifat nxitëse prej 85,5 eurosh.

14 Po aty, pjesa VI, para. 93–98.

15 Ankesa, para. 2.1.2.

16 Shih LKA, neni 22.7.

17 KI 11/09, Vendim, f. 3, para. fundit; shih dhe para. 14, sipër.

18 Padia, para. 95.

19 Po aty, para. 96–97; shih dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës (2008, ndryshuar 2016), neni 119; Ligjin 05/L-084, për rregullatorin e energjisë, neni 1.1.

24. Së treti, vendimi i ZRrE-së parasheh dhënien e subvencioneve për një periudhë 12-vjeçare. Shtyrja e ekzekutimit nuk e pakëson kohëzgjatjen e subvencioneve. Madje, nëse veç lejohet ekzekutimi pas vendimit përfundimtar të gjykatës, prodhuesit do të përfitojnë nga tarifa të larta fikse, ndërkohë që çmimi i energjisë në treg shkon duke rënë.²⁰
25. Prodhuesit nuk kanë bërë investime shkaku i vendimit të ZRrE-së, nuk kanë qenë palë në procedurë administrative, s'kanë pasur shkas të drejtpërdrejtë të presin përfitime, andaj s'mund të pësojnë dëm nga pezullimi.²¹ Ankuesi, që thotë se është përfitues i skemës mbështetëse, pretendon se ka futë shumë pare në punishten e vet. Por nuk jep kurrfarë provash. Fundja, askush s'është dashur të investojë në pritje të përfitimit, sidomos pa kaluar afati i padisë. Paditësi ka njoftuar publikisht për padinë dhe kërkesën për shtyrje në ditën që i ka dorëzuar.
26. Rrjedhimisht, çfarëdo pengese që mund t'i shkaktohet palës «Building Construction» nuk përbën «dëm të madh» sipas kuptimit të nenit 22 LKA. Andaj Gjykata duhet ta vërtetojë aktvendimin e shkallës së parë.

Aktvendimi për shtyrje nuk lëshohen në meritat e lëndës

27. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rastin vetëm për atë sa lejohet për të vendosur mbi shtyrjen e ekzekutimit.²² Gjykata nuk çmon nëse padia është e bazuar — kjo është punë për shqyrtimin përfundimtar.
28. Në pamundësi për ta goditur aktvendimin brenda shkaqeve të lejuara, ankuesi tani përpiqet ta shtyjë Gjykatën drejt vlerësimit të meritave, duke pretenduar se paditësi jo që nuk dëmtohet, por përfiton nga vendimi i ZRrE-së. Veçse ankuesi s'jep prova për të mbështetur pretendimet, ashtu jorelevante. Andaj Gjykata duhet t'ia refuzojë ankesën.²³
29. Gjykata e Apelit duhet të kufizojë shqyrtimin brenda fushëveprimit të nenit 22 LKA, dhe pa u lëshuar në meritat e rastit, ta vërtetojë aktvendimit e shkallës së parë shtyrje të ekzekutimit.

20 Po aty, para. 98.

21 Po aty.

22 LKA, neni 22; shih dhe Përgjigjen në ankesë, 30.1.2020, para. 21.

23 Padia, para. 4–7, 47–92.

III. PROPOZIM

30. Mbështetur në argumentet e mësipërme, dhe duke u thirrur në nenet 186.1, 196 dhe 209 të Ligjit për procedurën kontestimore, paditës-propozuesi i kërkon Gjykatës të nxjerrë **aktvendim** me të cilin:

- (1) ankesa e palës «Building Construction L.L.C.»:
 - (a) hidhet poshtë si e pasafatshme;
 - (b) hidhet poshtë si e palejueshme; ose
 - (c) refuzohet si e pathemeltë; dhe
- (2) **vërtetohet** Aktvendimi i 27 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Departamentit për Çështje Administrative, në lëndën A. nr. 3090/19.

Përfaqësuesi i paditës-propozuesit:

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com